

N A

MEKAMBES I PERGJITHSHEM I MADH. SE TIJ  
VIKTOR EMANUEELIT III.  
PER HIER TE ZOTIT E VULLNET TE KOMBIT  
MBRET I TALIES DHE I SHQIPNIES  
PERANDOR I ETHIOPIES

- - - -

DREJTORIA E PERSHITESHME  
E ARKIVARE TE SHTETE

Në virtyt t'Autoritetit që Na asht dolegue:  
Tue pa nenin I të Dekretit të Mekambësies Nr.178  
datë 11.XII.1939-XVIII;

Tue konsiderue se asht me interesë Publike smadhimi  
i ma përtejshëm i aeroportit të Tiranës, për të cilin bahet  
i nevojishëm çpronësimi i disa tokave;

Mbasi u pa kërkesa e Komandës Eprorë të Aeronauti-  
kës Mbretnore;

Mbi propozimin e Kryetarit të Këshillit të Minis-  
travet, Ministër i P.Botore ad interim;

KEMI DEKRETUE E DEKRETOJME:

Asht i deklaruem me interesë publiko smadhimi i  
dytë i Aeroportit të Tiranës, në kufit e shenuem me të kuq  
mbi hartën korografike që, e paeme me urdhënin t'Onë prej  
Ministrit propozues, i bashkanjitet ktij Dekreti.

Mbi hartën në fjalë janë të tregueme planet e par-  
celave dhe emnat e pronarve të tokave që janë subjekt çpro-  
nësimi.

Ministri propozues asht i ngarkuem për ekzekutimin  
e ktij Dekreti e per sa tjetër të kompetencës së tij, si mbas  
Dekretit t'Onë datë 11 Dhetuer 1939-XVIII, Nr.178.

Urdhnojmë që ky Dekret të botohet në Fletoren Zyr-  
tare të Mbretërisë tue i dhanë mandat cilitdo që i përket me  
e respektue dhe të bajë që të respektohet.

Tiranë, me 25.I.1940-XVIII.

FRANCESCO JACOMONI d.v.

Sh. Verlaci d.v.

Asht një me origjinalin  
retar'i Përgjith. i Kryeministriës e i Këshillit Ministrues  
Izedin Beshiri d.v.

7  
D E K R E T

mbi  
qpronisimin e tokave për amshimin e II<sup>ta</sup> t'aerodromit  
në Tiranë

N A  
MËKAMBËSI I PËRGJITHSHËM I MADHNIËS SË TIJ  
VIKTOR EMANUEELIT III  
Për Hir të Zotit e për Vullnet të Kombit  
MBRET I ITALIS DHE I SHQIPNIËS  
PERANDOR I ETHIOPIAS  
§§§§§§§§

Në virtyt t'Autoritetit që Na është delegue;

Mbasi u pë neni 1 i Dekretit të Mëkambësisë Nr.178 datë  
11.XII.1939-XVIII;

Mbasi u pë nevoja e qpronimit të disa tokave për vepra  
t'interesit botuar, që i përkasin Komandës së Naltë Ushtarake;  
Mbi propozimin e Kryetarit të Këshillit Ministrues,  
Zavendës Ministër i Punëve Botore;

KEMI DEKRETUE DHE DEKRETOJME :

qpronisimin për dobi të publike të tokave që vijojne e që gjinden në  
sinorin e Fushës Shëngjines: 1) Adem Xhepa m2. 22.395,59; 2) Ismail  
Nurizani m2. 5.726,25; 3) Vllazën Ali, Ahmet, Pajip, Nexhmedin e Hasan  
Qoralliu m2. 117.999,92; 4) Mahmut Abdyl Kurdari m2. 5.273,75; 5) Ki-  
sha Katolike m2. 2.079,75; 6) Hasan Qoku m2. 7.635,77; 7) Bajram  
Xhepa m2. 8.295,47; 8) Ismail Xhepa m2. 70,87; 9) Shaze Xhepa m2.  
7.691,60; 9bis) Shaze Xhepa m2. 9.309,77;

Ministri propozues është i ngarkuem me zbatimin e këtij De-  
kreti.

Ky Dekret hyën në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare të Mbretnisë.

Urdhënojmë që ky Dekret të botohet në Fletoren Zyrtare të Mbretnisë tue i dhënë mandat cilitdo që i perket t'a respektojë dhe të bajë që të respektohet.



KONCEPT

26/18

MBRETNIA SHQIPTARE  
MINISTRIA E PUNVE BOTORE

Tiranë, më 5.11.40.

*[Handwritten mark]*

XUCA

Drejt. P. të Shtypit Propagandës  
e Turizmit

Nr. \_\_\_\_\_

T i r a n ë

DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E ARKIVAVE TË SHTETIT

L A N D A :

Bashkanjton U dergojmë kopjen e Dekre-  
titi të Mëkambësisës së Përgjithshme mbi një  
zmadhim të dytë t'aeropotit në Tiranë, me lutje  
që të kenë mirësiën me e shpallun në të parin  
numer të Fletores Zyrtare.

Konceptuesi:

*[Handwritten signature]*

Protokolli:

*[Handwritten signature]*

Copist:

3/11.40

Idhije:

*[Handwritten mark]*

Zav. Ministr'i Punvet Botore  
K R Y E M I N I S T R I :  
KSHILLTAR' I PËRHERSHËM  
*Inq. L. Gamberini d.v.*

*[Handwritten mark]*



KONCEPT 9189/1

Tiranë, më 19 - XVII

MBRETENIJA SHQIPTARE  
MINISTRIJA E FINANCAVET  
DREJTORIJA E T' ARDHUNAVET

839

Nr. 9189/1

DREJTORIA E PERGJITHESHE  
E ARKIVAVE TE SHTETIT

Q A R K O R E

Gjith' FINANCOAVET TE MBRETNIS.

Lenda:

Merrni njoftim në Fletoren Zyrtare Nr.31 datë  
1 Mars 1940-XVIII, në të cilën asht botue Dekreti i Mbretit  
të Përgjithshëm të Madhnis së Tij Mbretit Ferandor, mbi shti-  
min e një paragrafi në nenin 12 të Dekretit datë 11 Dhatur  
1939-XVIII, mbi shpronsimet me interesë publike, për veprim  
në lidhje me veprimet q'i perkasin kompetencave t'Administra-  
tës Financjare.-

Drejtimi:

Ministri i Financoavet :

Konceptuar  
Qortuesi i konceptit  
Dikillografi  
Qortuesi

Drejtoris së t' Ardhunavet  
(Seksjonit të Tatimeve Direkte)

V o n d.

P ë r n j o f t i m .-

Ministri i Financoavet :

*Fajzi Kallaku*

Nisr me 9/3/1940 - XVIII

SEKREARI I PERGJITHSHEM  
(Kosta Marko)

Dossier:

NA

FRANCESCO JACOMONI DI SAN SAVINO  
MËKAMBËS I PËRGJITHSHËM I MADHNIS SË TIJ  
VIKTOR EMANUEELIT III  
PËR HIR TË ZOTIT E VULLNET TË KOMBIT  
MBRËT I ITALIS DHE I SHQIPNIS  
PERËNDUER I ETIOPIA

157  
DREJTORIA E PËRGJITHSHËM  
ARKIVAYE TE SHTETIT

KËSHILLI I EPËR FASHIST KORPORATIV, ka aprovuo;

NË virtyt t' autoritetit q' Na asht dhanu, komi sanksjonue dhe  
promulgojmë sa vijon:


KËthohet në ligjë Dekreti Mëkambësuer me datë 22.II.1940-XVIII  
Nr.59, mbi shtesë në Dekret-Ligjen Nr.178 datë 11-12-1939-XVIII, mbi  
shpronësimit për interesë publiko, pa ndryshime.

Kjo ligjë do të rradhohet në Fletoren Zyrtare të Mbretnis, tue  
i dhanu mandat oilitdo që i përket me e respektue dhe me ba qi të  
respektohet.

Tiranë, me 12-10-1940-XVIII

FRANCESCO JACOMONI D.V.

Asht një me origjinalin.  
Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit e i Këshillit Ministrues  
(Izedin Beshiri).

4  


158

DEKRET I MINISTRIT SEKRETAR SHTETI PER PUNE BOTORE

Ministri i Punve Botore;

Mbasi pas Dekretin Ministerjal date 24 Shtatuer 1940-XVIII, botue ne Fletoren Zyrtare datë 9 Tetuer 1940-XVIII, Nr.157 qe Urdharon shpronësimit e tokave qe nevojiten për smadhimin e dytë të sheshit aeroplanave në Tiranë;

Mbasi pas paragrafin e fundit t'Art.9 të Dekretit Mbkambësuer datë 11 Dhatur 1939-XVIII, Nr.178, qe parmban normat për shpronësime t'interesës publike;

U R D H E N O H I

Pagesën e shumës së depozituesve, pronarëve të shpronësuesve përkatës, emrat e të cilëve figurojnë në Dekretin Ministerjal të naltpërmendun.

Për sa ka sipër Administrata e Aeronautikës ka për t'intervemue pranë Arkës së Përgjithshme të Ministrisë së Financave për pagesën e sejoillit pronar të shpronësuesve, shumën e oaktueme, tue pamun për bazë note-transkriptimin ipotekore të pronës së shpronësuesve;-

Tirane, me 9 Manduor 1940-XIX. -



Zav. Ministr'i Punve Botore  
KRYEMINISTRI;

*[Handwritten signature]*

Lista e personave që kanë tërë t'akopune të fushës së Ajroplanave

- 1. Demisabloni
- 2. ...
- 3. ...
- 4. ...
- 5. ...
- 6. ...
- 7. ...
- 8. ...
- 9. ...
- 10. ...
- 11. ...

Vërtetohet

Komandant'i Stacionit Çentalit

Reshter

(Bahtijar Sulejmani)



Handwritten signature of Bahtijar Sulejmani.

